



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 60

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Prishtinë, më 23 janar 2013, në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa dhe Flora Brovina.

Mungoi: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- Administratore e Komisionit; Enis Halimi – Zyrtar i lartë i fushës për shëndetësi, Xheneta Sopjani-praktikante, Xhevdet Krasniqi, kryetar i Odës së Veterinarëve të Kosovës, Kurtesh Sherifi- veterinar dhe Istref Gashi- nënkryetar i Odës së Veterinarëve të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.1.2013;
3. Takim me përfaqësuesit e Odës së Veterinarëve të Kosovës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.1.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin nga mbledhja e datës 16.01.2013.

3. Takim me përfaqësuesit e Odës së Veterinarëve të Kosovës

Fikrim Damka- Tha se sot janë të pranishëm përfaqësuesit e Odës së Veterinarëve të Kosovës, të cilët kanë ngritur një çështje që eventualisht lidhet me punën tonë në Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësor.

Xhevdet Krasniqi- Tha se ne, si Odë e Veterinarëve, funksionojmë nga viti 2000, por e kemi statusin e organizatës joqeveritare. Ligji i veterinarisë nuk i përcakton në detaje funksionet dhe kompetencat e odës. Ne kërkojmë që të përfshihemi në kuadër të këtij ligji, pasi që jemi profesionistë shëndetësorë. Ne kemi kontaktuar përfaqësuesit Odës së Veterinarëve të Gjermanisë. Ata na kanë thënë se në Gjermani është një ligj i përbashkët për të gjitha odat. Ne, me këtë status që e kemi, nuk mund të bëjmë licencimin e veterinarëve. Anëtarë janë vetëm veterinarët që punojnë në sektorin privat, sepse ligji nuk i lejon veterinarët publikë të anëtarësohen në organizatë joqeveritare.

Kurtesh Sherifi- Tha se jemi të interesuar për t'u përfshirë në këtë projektligj. Në vendet e zhvilluara mjekësia shikohet si një e tërë. Mjeku veterinar është i barabartë me një mjek human. Përfshirja e veterinarëve në këtë ligj është në funksion të përmirësimit të situatës shëndetësore në vendin tonë. Nëse veterinarët nuk përfshihen në këtë ligj, atëherë duhet një ligj i ri. Organizimi ynë është funksional dhe nuk kemi nevojë për mbështetje financiare, e cila do të ishte barrë për buxhetin e shtetit.

Bahri Thaçi- Tha se gjërat duhet t'i marrim shtruar. Në komisionin tonë kemi vullnet t'u përkrahim. Sëmundshmëria është shumë e ndërlikuar. Receta, sipas ligjit, shkruan mjeku, stomatologu dhe veterinarin. Nuk ka diçka të keqe që edhe veterinarët të përfshihen në këtë ligj. Ne do të konsultohemi për këtë çështje.

Salihe Mustafa- Tha se ne duhet të konsultohemi me instance përkatëse. Ne duhet të shohim gatishmërinë e tyre se çfarë përgjegjësie do të marrin ata.

Time Kadriaj- Tha se MSH do të duhej të konsultohet për këtë çështje, gjatë hartimit të këtij projektligji. Ky është një ligj i ri dhe është model gjerman.

Liburn Aliu- Tha se ne do të duhej të takohemi me përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, ose përfaqësuesit e Agjencionit. Duhet të shikojmë se ku bie fushëveprimi, pra në cilën ministri dhe në cilën agjenci.

Fikrim Damka- Tha se ne duhet të konsultohemi me MSH, e pastaj edhe me Ministrinë e Bujqësisë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Fikrim Damka- Tha se jemi pak vonë me këtë projektligj. Unë nuk kam parë ndonjë vullnet për zgjidhjen e çështjeve, të cilat i preokupojnë pensionistët. Duhet të biem dakord të gjitha grupet se çka do të bëjmë me këtë projektligj.

Salihe Mustafa- Tha se ne duhet ta amendamentojmë këtë projektligj. Jemi të vetëdijshëm se nevojat janë të mëdha, por gjatë amendamentimit të shohim se çka mund të rregullojmë. Ministrisë i nevojitet ligji për të pasur një bazë për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet e tjera.

Bahri Thaçi- Tha se ne duhet të amendamentojmë projektligjin, jo vetëm sa për ta amendamentuar, por duhet që ligjin ta bëjmë në interes të pensionistëve. Gjithashtu, duhet ta kemi parasysh edhe interesin e shtetit. Duhet të gjejmë një zgjidhje të mirë. Ne kemi qenë që ky ligj të kthehet.

Liburn Aliu- Tha se ligji ishte dashur të kthehet. Ne duhet të kërkojmë nga MPMS që ta tërheq këtë ligj. Nuk ka ndonjë ndryshim domethënës nga versionin paraprak. Ne e kemi pasur një mbledhje me kryetarin e Kuvendit dhe ato konkluzat nga ajo mbledhje janë injoruar në tërësi. Ky ligj është i paamendamentueshëm nga ky pozicion në të cilin ne jemi.

Time Kadriaj- Tha se duhet ta bëjmë një ligj të mirë. Buxheti është i kufizuar. Duhet të shikojmë që brenda këtij kufizimi buxhetor të gjejmë një zgjidhje.

Gëzim Kelmendi- Tha se ne kemi pasur një përvojë me Ligjin për invalidët e luftës. Duhet të kujdesemi që puna e jonë të ketë efekt. Unë i mbështes kërkesat e pensionistëve. Duhet të punojmë me konsensus në këtë çështje. Ne, si Komision, duhet të japim një mesazh, që ta amendamentojmë këtë ligj apo ta kthejmë ligjin.

Flora Brovina- Tha se ligji nuk është i mirë. Nuk i plotëson as kushtet minimale për pensionistët. Qeveria i ka rritur pensionet. Nëse nuk e aprovojmë këtë ligj, ne vonohemi që ta bëjmë kategorizimin e pensionistëve. Problemi tjetër është se shteti ynë nuk mund të lidhë kontrata me shtete të tjera për pensionistët tanë që kanë punuar në vende të tjera. Ne nuk dijmë se çka po ndodh me fondin e grabitur nga Serbia. E dijmë se një kotest është fituar në Gjykatën e Strasburgut. Si Komision, duhet ta thërrasim dikë nga përfaqësuesit e UE-së që të na informojë lidhur me këtë.

Nazane Breca- Tha se ne e kemi kthyer njehere këtë ligj, por edhe ky variant nuk ka ndryshuar esencialisht ndonjë gjë. Kam frikë se nëse ne punojmë diçka në këtë ligj, ka rrezik se nuk do të mund ta miratojmë në seancë. Ne kemi pasur takim me FMN, por ata nuk përzihen ne menaxhimin e brendshëm të fondeve.

Liburn Aliu- Tha se Fondi pensional nuk mund të realizohet përnjëherë. Kjo do të bëhej vit pas viti, në parimin e solidaritetit. Sa më herët që fillon ndërtimi i Fondit pensional, aq më herët do të fillojë së funksionuari ai.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka